



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në “INXHINIERI NDËRTIMI”  
“Universiteti EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gafur MUKA

PhD. Igli Kondi

Korrik/2020

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Si një program i hapur qysh në vitin 2008 me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 12.03.2008 ai është zhvilluar si aktivitet mësimor e kërkimor shkencor për t'u vënë në provën e parë të vlerësimit, atë të akreditimit në vitin 2011, provë të cilën e ka kaluar me sukses. Për t'u përshtatur me kërkesat e zhvillimit të arsimit të lartë në vendin tonë dhe në plotësim të kuadrit ligjor për arsimin e lartë, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 213, datë 25.05.2012, ai u strukturua për t'u zhvilluar me 180 ECTS nga 240 ECTS që kishte deri në atë kohë. Me këtë strukturë dhe me një përvojë arritjesh disaveçare Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka marrë akreditimin e tij te parë periodik institucional bazuar në vendimin Nr. 79, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit.

Të dhënat sipas akteve ligjore janë:

**Njësia Bazë (Kryesore):** Programi ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë), miratuar edhe me Vendim Senati Nr. 12, datë 28.09.2017.

**Licencimi/Riorganizimi:** Programi është licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 12.03.2008. Programi është riorganizuar nga Bachelor 4 - vjeçar në Bachelor 3- vjeçar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 213, datë 25.05.2012 (VKA Nr. 313, datë 16.03.2012).

**Akreditimi:** Akreditimi i fundit është vendosur me VBA Nr. 79, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me vlefshmëri deri më 30.09.2020.

Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u ngjizur atyre aftësi për të konkretizuar njohuri inxhinierike, aftësi për të vetvepruar në kuadrin e organizimit e kryerjes së punëve zbatuese në kantier, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionale, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën profesionale, aftësi në menaxhimin e projekteve, njohjen e standarteve dhe metodologjive bashkëkohore.

Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij PS realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicje të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Master e Doktoratë.

Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" zhvillohet si një program i sukseshëm studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka marrë akreditimin e tij të parë periodik institucional bazuar në vendimin Nr. 79, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit. Rekomandimet e lëna për t'u përmbushur në kuadrin e këtij akreditimi lidhen me:

1. Plotësimin me paisjet e nevojshme të laboratorit të inxhinierisë së ndërtimit për trajtimin laboratorik të studentëve të këtij PS.
2. Ofrimin e literaturës së nevojshme teknike në gjuhën shqipe;
3. Përfshirjen në objektivat e programit të studimit të mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë PS;
4. Ofrimin e mundësive për studentët që të adoptojnë terminologji teknike në gjuhën angleze nëpërmjet lëndëve të veçanta;
5. Rishikimin e mundësisë së zvogëlimit të ngarkesës së studentëve, veçanërisht në vitin e tretë të studimeve.

Për të gjykuar mbi masën e plotësimit të këtyre rekomandimeve GVJ konsultoi fillimisht RVB dhe më pas, gjatë vizitës në institucion, ai u interesua të njëjherë konkretisht me rezultatet e plotësimit.

Për rekomandimin e parë GVJ vizitoi laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit ku gjeti pajisjet e reja, të cilat shefi i departamentit na i tregoi duke na shpjeguar dhe funksionimin e tyre. Edhe në bisedën me studentët, ata pohuan se ky laborator u shërben atyre jo vetëm për të konkretizuar njohuritë e fituara gjatë leksioneve por edhe për të krijuar të dhëna në interes të aktivitetit kërkimor shkencor.

Për përmbushjen e rekomandimit të dytë, GVJ vizitoi edhe bibliotekën e institucionit ku gjeti tituj librash inxhinierikë në gjuhën shqipe si dhe një fjalor teknik anglisht-shqip. Antarë të personelit akademik të Fakultetit të Arkitekturës e Inxhinierisë ishin bashkëautorë të fjalorit të inxhinierisë së ndërtimit, botuar në katër gjuhë.

Në përmbushje të rekomandimit të tretë, GVJ konstatoi që mundësitë e punësimit të studentëve ishin përfshirë në objektivat e departamentit. Gjithashtu për këtë funksiononte edhe zyra planifikimit të karrierës.

Në përmbushje të rekomandimit të katërt, që lidhet me adoptimin e terminologjisë teknike në gjuhën angleze, GVJ e gjen të përmbushur. Ai u njoh me axhendën e organizimit të kurseve të shkurtëra si dhe leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e profesionistëve nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit. Në këto aktivitete shpjegoheshin edhe terma teknikë të gjuhës angleze, në mënyrë që studentët të avancojnë shpejt e me siguri në përdorimin e tyre. Nga biseda me studentët mësuam që ata kishin përfituar mjaft nga këto organizime.

GVJ mësoi që për përmbushjen e rekomandimit të pestë është dashur ndërhyrja në kurrikulën ekzistuese, çfarë është bërë nga Departamenti në vitin akademik 2017-2018. Për të vlerësuar dobinë e kësaj ndërhyrjeje GVJ bisedoi me studentët ku mësoi se ata gjykonin që kurrikula e rishikuar ishte më e ekuilibruar në shpërndarjen e ngarkesës.

**Në përfundim GVJ konstaton që të pesta rekomandimet janë përmbushur plotësisht.**

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). Grupi u njoh dhe studjoj dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me axhendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datat 11 dhe 12 qershor 2020.

Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Shefin e Departamentit të PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore, Zyrës së Hulumtimit të Projekteve etj. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”.

Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimin të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënjen, mësimnxënjen dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Koordinator teknik i procedurës është ME Renata Qatipi.

Më datë 09.07.2020, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë zyrtare Nr. 123/3 Prot., datë 13.07.2020, Universiteti “EPOKA” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 14.07.2020, IAL përcjell përgjigjen nëpërmjet AMS se “nuk kanë komente për draft raportin”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet ne Raport përfundimtar.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Inxhinieri Ndërtimi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Protokoll i takimeve), GVJ konkludon që programi i studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ofron një kurrikulë mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të mirëasimilueshëm, infrastrukturë e logjistikë të përshtatshme dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës dhe të mirëpritur nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për të ndërtuar sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë.  <i>Referencë: DVV (RVBP, aneksi 4,5), Protokoll i takimeve gjatë vizitës në Institucion)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	PS Bachelor në “Inxhinieri ndërtimi” ka funksionuar si PS qysh nga viti akademik 2007-2008. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e ndërtimit. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore.  <i>Referencë: DVV (RVBP, aneksi 4, 5), Protokoll i takimeve gjatë vizitës në Institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe syllabuset e lëndëve por edhe planet strategjike të institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe gjen që ky PS është konkures në kuadrin kombëtar dhe ka ambicjen të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Në RVB thuhet: “Universiteti "EPOKA" synon të rrisë individë të përgatitur, produktivë dhe kompetentë me një frymë të orientuar drejt kërkimit shkencor, të cilët posedojnë etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale dhe gjithashtu janë të hapur drejt sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare”. Në këtë perspektivë duket qartë që ky PS zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Referuar kurrikulës së këtij programi studimi konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij PS konstatohet që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai

	angazhohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar përcaktimit të RVB-së se: “Universiteti "EPOKA" synon të rrisë individë të përgatitur, produktivë dhe kompetentë me një frymë të orientuar drejt kërkimit shkencor, të cilët posedojnë etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale dhe gjithashtu janë të hapur drejt sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare” si dhe gjetjeve të tij gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që PS Bachelor në “Inxhinieri ndërtimi” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ i konsultoi paraprakisht të dy dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Universitetit "EPOKA" dhe gjeti që në nenin 3 të statutit përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e Universitetit. Në mënyrë të veçantë programet e studimit të ciklit të parë hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin e Universitetit (Statuti i Universitetit "EPOKA", nenet 83-88). Zbatimi i përcaktimeve statutores dhe rregullore të institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Si një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 281, datë 12.03.2008, dhe në dispozitat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, në zbatim të Urdhërit Nr. 286, datë 06.07.2012, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, Universitetit "EPOKA" është dhënë akreditimi institucional si dhe akreditimi i programeve të Studimit.  Në zbatim të Urdhrit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 213, datë 25.05.2012, program i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" me një kohëzgjatje normale prej katër vitesh studimi akademike (240 ECTS) është riorganizuar në programin e studimit me një kohëzgjatje normale prej tre (3) vitesh akademike (180 ECTS). Ky program ka marrë akreditimin e parë periodik institucional, bazuar në vendimin Nr. 79, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit duke konfirmuar kështu që emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij është në përputhje me fushat dhe orientimet akademike të institucionit.  Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave të DVV-së, konstaton që PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, i cili ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi bazë dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe

	drejtimet akademike të Universitetit Epoka. <i>Referencë: DVV (Aneks 2, 4, 5, 7)</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke nxitur pasionin për t'i thelluar njohuritë në ciklet e tjera të studimeve, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e rezultateve të analizave laboratorike, duke njohur konkurrencën në tregun e punës, dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre.</p> <p>Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabuset e lëndëve, kostatohet që në këtë PS synohet t'u jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. aftësi për të zbatuar njohuri të matematikës, disiplinave shkencore dhe inxhinierike;</li> <li>2. aftësi për të hartuar një sistem përbërës ose proces në përbushje të nevojave të dëshiruara;</li> <li>3. aftësi për të funksionuar në ekipe multidisiplinare ;</li> <li>4. aftësi për të identifikuar, formuluar dhe zgjidhur probleme inxhinierike;</li> <li>5. përceptim të përgjegjësise profesionale dhe etike;</li> <li>6. aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive;</li> <li>7. edukim për të kuptuar ndikimin e zgjidhjeve inxhinierike në një kontekst global dhe shoqëror;</li> <li>8. njohje të nevojës dhe disponim të aftësisë për t'u përfshirë në mesimnxënie përgjatë gjithë jetës;</li> <li>9. përditësim të njohurive bashkëkohore ;</li> <li>10. aftësi për të përdorur teknikat dhe mjetet moderne inxhinierike të nevojshme për punën si inxhinierë etj.</li> </ol> <p><i>Referencë: Dokumentet e DVV (Tabela përmbledhëse e anekseve, Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018 , (Tabela 14), f.26), Protokoll i</i></p>



	<p><i>takimeve gjatë vizitës në institucion)</i></p> <p>Në bisedën me studentët ata u shprehën që e vlerësojnë si një avantazh të dukshëm faktin që mësimi zhvillohet në anglisht pasi kjo i ndihmon ata të ndjekin zhvillimet më të fundit të arritjeve bashkëkohore në fushën e ndërtimit si dhe në shkurtimin e kohës së përshtatjes me kushtet që ofrohen gjatë studimeve në universitetet jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës. Ai dispononte evidenca të plota mbi punëzënien e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, GVJ u njoh me aktivitetin konkret për ndjekjen e tregut të punës dhe përdorimin e të dhënave të fituara nga kontaktet me firmat ndërtuese. Përveç komunikimit të formalizuar në dokumenta për interesin reciprok, në këtë zyrë disponoheshin edhe informacionet që merrnin studentët gjatë zhvillimit të praktikave në terren. Mbi bazën e këtyre të dhënave, kjo zyrë i këshillonte në vazhdimësi të diplomuarit që të kontaktonin me firmat e interesuara. Rezultati i këtij aktiviteti konkretizohej në statistikën e gjendjes së të diplomuarve, e cila aktualisht paraqitej si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 65.8% të punësuar në sektorin privat</li> <li>- 10.5% në administratën shtetërore</li> <li>- 7.9 % në studimet për mastër</li> <li>- 13.2% në gjendje pritjeje</li> <li>- Për 2.6% nuk kishte të dhëna.</li> </ul> <p>Duke patur parasysh konkurrencën në tregun e punës, statistika e mësipërme duket e kënaqshme sa i përket gjendjes së punësimit, çfarë përbën avantazh për PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në aspektin formues objektivat e PS Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi“ synojnë <i>t’u sigurojnë studentëve dhe të diplomuarve dije profesionale, zotësi në përdorimin e tyre, kuptim dhe zgjidhje të problemeve në ndërtim, dëshirë dhe ambicje për të njohur e përvetësuar informacionin bashkëkohor</i> etj. Realizimin e këtyre objektiveve GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi për produktin e deritanishëm si dhe duke analizuar kurikulën egzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentëve. Caktimin e një tutori studimesh (këshilltar akademik), që i shoqëron studentët gjatë gjithë kohës së studimeve, GVJ e vlerëson si një gjetje me vlerë në përcelljen dhe realizimin me efikasitet të lartë të ndihmës për studentët. Gjithashtu në drejtim të lidhjes me tregun e punës ishte shumë i dobishëm edhe aktiviteti i Zyrës së Planifikimit të</p>



	Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Nisur nga këto, GVJ konstaton që Institucioni i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi". Në RVB burimet përvoja dhe kapacitetet e Universitetit Epoka paraqiten si më poshtë:</p> <p><u>Burimet Infrastrukturore</u> : Mjedise për studentët (Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Mjedise sociale dhe sportive); Mjedise për stafin (Zyrat, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, Mjedise shlodhëse).</p> <p><u>Shërbime IT</u> (Shërbime Mësimdhënie (Turnitin, LMS, Koha, DSpace), Google Services, Epoka Interactive Systems (EIS) Education Information System (Kurrikula), Smart Card, Help Desk, Programe, Rrjet).</p> <p><u>Burimet njerëzore</u>: Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik (kombëtar dhe ndërkombëtar), me një përvojë të gjerë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</p> <p>Në strukturën përbërëse të Fakultetit janë 3 departamente: Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (Dep. Përgjegjës për programin e studimit),</p> <p>Departamenti i Arkitekturës</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti (30 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Profesor,</li> <li>- 5 Profesorë të Asociuar,</li> <li>- 15 Doktor/Docent</li> <li>- 2 Doktor në proces</li> <li>- 7 Msc.</li> </ul>

	<p>Në nivel Departamenti përgjegjës (7 pedagogë) si PAE:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof. As,</li> <li>- 3 Doktor</li> <li>- 2 Msc</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton egzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve. <i>Ref. Nr. ANEKS: tabelat përmbledhëse, Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" Tab. 1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. GVJ mësoi që kjo është realizuar duke përdorur kodifikimin e vet të programeve të studimit dhe lëndëve në përputhje me fushën e veçantë të studimit, pasi kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nuk është aprovuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Interesimit të GVJ lidhur me zëvendësimin e këtij kodi me atë kombëtar duke ruajtur strukturën e programit dhe lëndëve, përfaqësuesi i institucionit iu përgjigj se "është formatuar në mënyrë të tillë që të mos ketë problem"</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ iu referua gjetjes në RVB ku thuhet: "Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit i cili, sipas ligjit të arsimit të lartë është njësi bazë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Departamenti ka të drejtë të japë grada universitare duke ofruar trajnime akademike për studentët dhe promovon kërkime shkencore në nivelin më të lartë. Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor, Master dhe Doktoratë. Departamenti mirëpret studentët që dëshirojnë të studiojnë për programet e studimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe me procesin Evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve".</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Në Planin Strategjik të këtij departamenti GVJ gjeti objektivat dhe synimet e Departamentit lidhur me zhvillimin e PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi". Në kushtet e mungesës së kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" institucioni, që nga themelimi i tij ka zbatuar kodifikimin e vet të programeve të studimit dhe lëndëve në përputhje</p>

	me fushën e veçantë të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti "EPOKA" ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua nga dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit për një sërë aktivitetesh me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve të tri njësive bazë të fakultetit. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta.</p> <p>GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas.</p> <p><i>Referencë: Dokumentet e DVV (RVBP), Protokollit i takimeve gjatë vizitës në Institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendës e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Në projektet brenda vendit ishin aktivizuar 2 studentë doktorantë ndërsa në projektet jashtë vendit, me objektiv përmirësimin e kapaciteteve, ishin në proces 6 projekte, dy nga të cilët përfundonin ndërsa 4 të tjerë ishin në vazhdim. Një projekt konkret në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit ishte ai i mbrojtjes nga zjarri. Kjo zyrë merret edhe me kontrollin e financimeve si dhe me realizimin e detyrimeve për publikimin e punës kërkimore shkencore. Synimi është publikimi në organet me nivel të lartë kërkesash, pra faktorë të lartë impakti, çfarë edhe shpërblehet.</p> <p>Sa i përket shërbimit për të tretët GVJ mësoi që ai koordinohet nga një</p>

	<p>organizim i posaçëm që quhet CORDA.</p> <p>GVJ u informua gjithashtu që studentët e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" mund të përfitojnë edhe nga mundësitë e ofruara nga kompani vendase në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit që ata kanë me universitetin. Disa nga ndërmarrjet janë: Gener 2, ICE, Jupiter, Kontakt shpk, KPMG, Alufloor, Jon shpk, Alba Building, ALTEA, Instituti i Ndërtimit, Salillari, Orion Construction, Gjoka Construction, Titan-Antea Cement, ERMC, Alb Star, Hidrocentrali i Devollit-Statkraft, TAP, Alba Via, MANETCI, Kastrati Construction, etj.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 32), Protokollin e takimeve gjatë vizitës në Institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ mësoi se çdo vit nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit hartohet një Raport Vjetor në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve.</p> <p>Me qëllim rritjen e përfitimeve nga bashkëpunimi me jashtë Departamenti kishte emëruar një anëtar përgjegjës për krijimin e kontakteve dhe rritjen e numërit të marrëveshjeve përmes Erasmus + si dhe memorandumeve të mirëkuptimit me universitete të tjera jashtë vendit. Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve dhe Marrdhënieve Ndërkombëtare mësuam se përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit janë kryesisht në formën e paisjeve dhe shpërblimeve për stafin.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit përmes Dekanit të Studentëve përkatësisht Zyrës të Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Vetë departamenti ishte aktiv në mbështetjen e marrëdhënieve me ndërmarrjet/ punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe organizimeve të përbashkëta.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që Universiteti "EPOKA" ofron trajnime të mëtejshme profesionale për të diplomuarit në koordinim me punëdhënësit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Panairin e Karrierës, i cili vlerësohet si një ngjarje vjetore që synonte të ofronte mundësi punësimi dhe praktike për studentët dhe të diplomuarit e këtij institucioni, me pjesëmarrjen e më shumë se 60 kompanive.</li> <li>➤ Trajnim karriere, i ofruar për t'i informuar studentët se si të përgatisin CV-në e suksesshme;</li> <li>➤ Departamenti, bazuar në kalendarin vjetor të aktiviteteve, mbështet trajnime profesionale nëpërmjet leksioneve të hapura, workshop-eve dhe udhëtimeve studimore.</li> </ul>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b></p>

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b> <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra të rregullt. Për ti ofruar studentëve mundësi shtesë, ofrohen edhe semestra vere të zhvilluara me kohë të përshpejtuar. Ofrimi i lëndëve në semestrat e verës realizohet në bazë të kërkesave të studentëve për cdo lëndë specifike dhe rregullohet me anë të rregullores për shkollën e verës.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 35 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollorë (12 lëndë në vitin e parë; 11 lëndë në vitin e dytë; 12 lëndë në vitin e tretë). Në 35 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 33. Lëndë me zgjedhje janë 2. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Gjithashtu, paralel me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), institucioni përdor edhe kreditet amerikane, dhe sistemin e vlerësimit GPA amerikan. Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Studentët kanë mundësinë të rregjistrojnë cdo semestër deri në 45 ECTS.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p>

	<p>Kreditet amerikane të cdo lënde përlogariten duke duke konsideruar orët e leksioneve teorike javore plus gjysmën e orëve javore të praktikave, laboratorëve, projekteve dhe seminareve.</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjere specialitetesh të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune në analizë, dizajn dhe menaxhim ndërtimi. Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kontraktorët e ndërtimeve, firmat këshilluese, firmat industriale, agjensitë e ndryshme qeveritare, etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxh. Ndërtimi janë të larmishme. Fillohet nga gjuha angleze, vazhdohet me matematikë, fizikë, kimi, informatikë e deri te mekanika, statika, analiza e strukturave, hidraulika, gjeodezia, etj. Programet lëndore (syllabuset) të hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave, dizenjimi i themeleve), inxhinierisë strukturore (analiza dhe projektimi i betonit të armuar dhe strukturat e çelikut), inxhinierisë hidraulike (funizim me ujë dhe kanalizime, burimet ujore), etj.</p> <p>Si pasojë programi ofron njohuri të përparuar, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><i>Ref. Kurrikula e PS</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke iu referuar Kurrikulës së Programit Studimor, vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuar në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me analizën e strukturave, strukturat b.a., strukturat e çelikut, themelet, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>Kurrikula dhe programet e lëndëve (syllabuset), të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, janë në përputhje të plotë me VKM-ët e mësipërme.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" është një program studimi i ciklit të parë. Ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS. Forma e studimeve të</p>



	<p>programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është anglisht.</p> <p>Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma "Bachelor" në Inxh. Ndërtimi.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 6 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 18 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 6 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kategoria A - 19.4%</li> <li>• kategoria B - 53.8%</li> <li>• kategoria C - 15%</li> <li>• kategoria D - 8.8%</li> <li>• kategoria E - 2.7%</li> </ul> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <i>Ref. Kurrikula e PS</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit është pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet nga tre njësi bazë, apo departamente.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 5 (pesë) zotërojnë të paktën gradën "Doktor".</p> <p>Universiteti EPOKA ka përmbushur standardet institucionale dhe ka marrë akreditim fillestar dhe periodik në nivelin institucional bazuar në VBA nr. 92, datë 20.10.2017 “Për akreditimin periodik të Universitetit EPOKA. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ka marrë akreditimin periodik bazuar në vendimin nr 79, datë 21.09.2017 “Për akreditimin periodik të PS Bsc “Inxhinieri Ndërtimi” të Bordit të Akreditimit, dhe Urdhër nr. 565, datë 22.11.2011 “Për regjistrimin e formës së diplomës”.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në nenin 12 të Statutit të Universitetit “EPOKA”, Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, si dhe për sigurimin brendshëm të cilësisë.</p> <p>Drejtuuesi i Departamentit është gjithashtu koordinatori akademik i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit EPOKA, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. Universiteti EPOKA është i përbërë nga tre fakultete, të cilët nga ana e tyre përbëhen nga të paktën tre njësi bazë (departamente/qendra kërkimore - shkencore). Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Drejtuesit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është Administratori i Fakultetit.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet nga 3 (tre) Departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Arkitekturës;</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;</li> <li>3. Departamenti i Inxhinierisë Kompiuterike.</li> </ol> <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, që ofron programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Ligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket organizimit dhe strukturën së tij akademike.</p> <p><i>Ref.: Statuti i Universitetit EPOKA, Rregullorja e njësisë bazë/njësive kryesore, dhe Rregullorja e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm shkruhet se Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 5 (pesë) zotërojnë të paktën gradën "Doktor". Konkretisht, për vitin akademik 2019-2020, Personeli Akademik Efektiv (PAE) përbëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof. As,</li> <li>- 3 Doktor</li> <li>- 2 Msc</li> </ul> <p>Personel Akademik me Kontratë (PAK):</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 1. Prof. As,</li> <li>- 1 Msc</li> </ul> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë gjithsej ka 30 PAE dhe 22 PAK. përbëhet nga tre njësi bazë, apo departamente, në të cilën stafi akademik është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Arkitektures (8 PAE)</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierise se Ndertimit (7 PAE)</li> <li>3. Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike (15 PAE)</li> </ol> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Ref.: Anekset e detyrueshme me tabelat përmbledhëse, Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi"</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 35 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollorë (12 lëndë në vitin e parë; 11 lëndë në vitin e dytë; 12 lëndë në vitin e tretë). Në 35 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 33. Lëndë me zgjedhje janë 2. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Në kategorinë A bëjnë pjesë 6 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 18 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 6 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 35 ECTS (19.4%)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 97 ECTS (53.8%)</li> <li>- Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 27 ECTS (15%)</li> <li>- Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 16 ECTS (8.8%)</li> <li>- Kategoria E (detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 5 ECTS (2.7%)</li> </ul> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxh. Ndërtimi përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në programet e lëndëve.</p> <p>Konkretisht, në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 5-10 % pjesëmarrja</li> <li>- 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</li> <li>- 20-30 % testimet gjatë vitit</li> <li>- 40-50 % provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur detyrim mbi 60%.</p> <p><i>Ref.: Rregullorja e programit të studimit, Programet Lëndore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet Zyrës të Pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e PS, kriteret bazë për pranimin e studentëve janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studentët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ose një diplomë ekuivalente;</li> <li>2. a. Nota mesatare e shkollës së mesme jo më pak se 7.00 nga 10.00</li> </ol>

	<p>ose ekuivalente.</p> <p>2. b. Specifikist për programet Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterrike dhe Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital nota mesatare e lëndëve të Matematikës dhe Fizikës, jo më pak se 7.00 nga 10.00 ose ekuivalente.</p> <p>3. Çertifikatë e Anglishtes Niveli B1 Si sipas CEFR në një nga provimet e miratuara</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet EPOKA dhe ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p><i>Ref.: Programet lëndore të lëndëve të ofruara ndër vite</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti, dhe rregullohet përmes Politikës së Universitetit “EPOKA” “Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit”.</p> <p>Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga Departamenti përkatës, Fakulteti, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave nën Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senatit Akademik, dhe dosja e plotë arkivohet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.4</b>  <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri,</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Në</p>

aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, anglisht, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të inxhinierisë gjeoteknike, inxhinierisë strukturore, inxhinierisë hidraulike dhe qasjes së sistemeve të përgjithshme për problemet e inxhinierisë. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë verore, si edhe njihen me përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, anglisht, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Një perceptim i fortë i parimeve praktike dhe fizike nxitet dhe promovohet, duke ofruar një bollëk mundësish mësimnxënije.</p> <p>Përgjatë programit, studentëve u ofrohen mundësi që të përforcojnë aftësitë e tyre grafike dhe të komunikimit me gojë. Një sasi e konsiderueshme kohe është e lidhur drejtpërdrejt me trajnimin praktik në testimin e materialeve, udhëzime në përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike, etj.</p> <p>Viti i dytë dhe i tretë përbëhen kryesisht nga lëndë themelore të inxhinierisë që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave, projektimi i themeleve), inxhinieria strukturore (analiza dhe projektimi i strukturave të betonit të armuar dhe çelikut), inxhinieria hidraulike (rrjedha e ujit në tuba, kanale të hapura, burime ujore). Dy vitet e fundit të programit të studimit i dedikohen studimit të plotë të bazave teorike të shkencës së inxhinierisë të ndërtimit. Në të njëjtën kohë, zbatimi praktik i njohurive të inxhinierisë të ndërtimit paraqitet dhe zbatohet përmes detyrave të kursit dhe projekteve. Studentëve iu ofrohen njohuri menaxheriale, si edhe kryerja e një praktike verore në kantier.</p> <p>Për më tepër, studenti sfidohet duke parë rolin e inxhinierit nga një këndvështrim ndërdisiplinor dhe multidisiplinor. Zhvillohet gjithashtu roli i inxhinierit si menaxher. Për të zhvilluar më tej aftësi inxhinierike për praktikën profesionale, programi i studimit përfundon me plotësimin e një praktike verore.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor.</p> <p>Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>



	<i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij, CV e stafit akademik të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblyëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani ndërtimi. Gjatë lëndës Praktika Verore CE301, studentët duhet të përfshihen rregullisht në praktikën e tyre në ndërmarrjet e ndërtimit dhe duhet të paraqesin dëshmi të pjesëmarrjes dhe angazhimit si parakusht për përfundimin e lëndës dhe diplomimin në fund të programit.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në praktika verore të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me ndërmarrje dhe industri që operojnë në këtë fushë, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse, po jo detyrimisht të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Ref.: Programet Lendore, Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book) të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me</p>

	<p>prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>Ref.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij, Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët industrialë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.</p> <p><i>Ref.: Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve, Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b></p> <p><b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>																																																									
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>																																																								
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Ndërtimi <u>në tre vitet e fundit</u>, është me grada dhe tituj, dhe kualifikim Msc, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Personeli akademik i brendshëm (PAE) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim (Tabela 6):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof As</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr ne process)</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td><b>totali</b></td> <td><b>11</b></td> <td><b>12</b></td> <td><b>9</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik i jashtëm (PAK) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim (Tabela 6):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof As</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr ne process)</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td><b>totali</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>5</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Raporti i tyre i llogaritur me ngarkesën në orë mësimore (Tabela 12) rezulton:</p> <p><u>Për 2017-2018</u> PAE 138 ECTS (77%) dhe PAK 42 Kredite (23%)</p>		2017-2018	2018-2019	2019-2020	Prof. Dr	-	-	-	Prof As	2	2	2	Dr/PhD	4	5	5	Msc (Dr ne process)	4	3	2	Msc	1	2		<b>totali</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>9</b>		2017-2018	2018-2019	2019-2020	Prof. Dr	-	-	1	Prof As	1	1	1	Dr/PhD	5	3	2	Msc (Dr ne process)	1	0	0	Msc	3	3	1	<b>totali</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>5</b>
	2017-2018	2018-2019	2019-2020																																																						
Prof. Dr	-	-	-																																																						
Prof As	2	2	2																																																						
Dr/PhD	4	5	5																																																						
Msc (Dr ne process)	4	3	2																																																						
Msc	1	2																																																							
<b>totali</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>9</b>																																																						
	2017-2018	2018-2019	2019-2020																																																						
Prof. Dr	-	-	1																																																						
Prof As	1	1	1																																																						
Dr/PhD	5	3	2																																																						
Msc (Dr ne process)	1	0	0																																																						
Msc	3	3	1																																																						
<b>totali</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>5</b>																																																						



	<p><u>Për 2018-2019</u> PAE - 141 ECTS (78%) dhe PAK - 39 Kredite (22%)</p> <p><u>Për 2019-2020</u> PAE - 146 ECTS (81%) dhe PAK - 34 Kredite (19%)</p> <p>Pra në të tre vitet plotësohet kriteri ligjor për PAE që ka mbështetur me mbi 70% ngarkesën mësimore</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të Inxhinirisë së Ndërtimit si: inxhinieri stukturash, materiale, menaxhim, gjeoteknike, hidroteknike, etj. Lëndët ofrohen nga pedagogë me tituj akademikë dhe disa lëndë mbikëqyren nga një grup pedagogësh (p.sh. Introduction to Civil Engineering, Civil Engineering Drawing).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme, shiko për këtë aneksin 34 te RVB. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet Zyrës së Dekanit të Studentëve, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve në Inxhinieri Ndërtimi. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me ndërmarrjet / punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella. Praktika e detyrueshme, lënda Praktika Verore CE301, mbikëqyret bashkërisht nga mbikëqyrtësi në vendin e praktikës dhe anëtari i caktuar i stafit akademik të departamentit.</p> <p><i>Ref. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Çdo leksioni dhe seminari i është caktuar një klasë në përputhje me nevojat e veçanta të lëndës. Gjatë orëve të mësimin, pedagogët ndihmohen nga asistentët mësimorë dhe/ose asistentët kërkimorë. Laboratorët e kompjuterave mirëmbahen nga personeli administrativ përkatës nën përgjegjësinë e Zyrës së IT, ndërsa Laboratori i Inxhinierisë të Ndërtimit mirëmbahet nga përgjegjësi i laboratorit, stafi teknik dhe stafi akademik.</p> <p>Universiteti EPOKA mbështet programin e studimit me staf me kohë të pjesshme, nëse e shih të nevojshme të mbulojë lëndë të veçanta ose të punësojë personel shtesë për të mbështetur stafin aktual.</p> <p><i>Ref.: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Universiteti organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Keto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave të ndryshme inovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit. Për semestrin akademik pranverë 2019-2020, institucioni hartoi një material udhëzues mbi metodat dhe platformat e mësimdhënies në distance. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit.  <i>Ref: Strategjia Kuadër e Universitetit "EPOKA" 2018-2022</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Drejtuesi i departamentit është direkt personi përgjegjës për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Në fund të çdo semestri analizon punën e të gjithë anëtarëve të stafit dhe bën vlerësimet përkatëse. Raporti i përgatitur nga Drejtuesi i Departamentit i dorëzohet fakultetit dhe pastaj i përcillet rektoratit. Bazuar në "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" dhe Politikës së Universitetit EPOKA, "Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit", institucioni aplikon pyetësorin e vlerësimit të pedagogëve të lëndëve dhe vizitat në klasë, si masa për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në fund të çdo semestri studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndës, i cili bazohet në përvojën e shumë universiteteve të shquara. Paraqiten pyetje të shumta, me qëllim vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Nga ana tjetër, studentët janë vazhdimisht në kontakt me zyrën e dekanit të studentëve, përmes përfaqësuesve të tyre, të zgjedhur, ose individualisht. Shqetësimet apo vërejtjet mund të paraqiten në lidhje me lëndën ose pedagogun.  Pyetësori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është i përbërë nga katërbëdhjetë pyetje. Pyetësori kërkon pikëpamjet dhe komentet e studentëve për çështje të tilla si përpikmëria e pedagogëve, përgatitja e lëndës, zotërimi i njohurive të lëndës, materiali i lëndës, ndërveprimi me studentët, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së

	<p>studentëve, menaxhimi i kohës. Kjo pasohet nga një pyetje e hapur, e cila krijon mundësinë e sugjerimeve për përmirësimin e lëndës dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p><i>Ref: Pyetësi për Vlerësimin e Pedagogëve/Lëndës</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Pyetësi për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies në Universitetin EPOKA. Pyetësi zhvillohet në fund të çdo semestri. Rezultatet e përgjithshme të pyetësit janë pjesë e raportit vjetor të përgatitur për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilat bëhen publike në fund të çdo viti akademik në faqen kryesore të internetit të institucionit. Njëkohësisht, në mënyrë periodike dhe në përputhje me planin, përgatiten raporte të vlerësimit të brendshëm, sipas legjislacionit përkatës. Raportet e vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të Universitetit EPOKA.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në Udhëzimin “Për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë”, institucioni ka miratuar "Formularin e Matjes dhe Vlerësimit të Performancës Akademike" që vlerëson performancën e mësimdhënies në shkallë të nivelit 1-5. Niveli 1 (U): I pakënaqshëm; &lt;2.5; Niveli 2 (I): Përmirësim i nevojshëm; &lt;3.0; Niveli 3 (ME): Përbush pritshmëritë; 3.0-3.50; Niveli 4 (EE); tejkalon pritshmëritë 3.5-3.79; Niveli 5 (E): I jashtëzakonshëm. &gt; 3.8.</p> <p>Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimit, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus + KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit e universitetit.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b></p> <p><b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione <b>1360</b> (496 + 432+ 432) orë mësimore</li> <li>- Praktikë/Seminare <b>720</b> (224+ 224+272) orë mësimore</li> <li>- Laboratorë <b>90</b> (0+ 42+48) orë mësimore</li> <li>- Site W <b>518</b> (87+ 137+ 294) orë mësimore</li> <li>- Punë individuale e st. <b>1828</b> (693+ 665 +470) orë mësimore</li> </ul> <p>Përveç kësaj Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit organizon udhëtime në terren ose ëorkshope në mënyrë që të mbështesin procesin e mësimdhënies. Disa nga këto aktivitete janë të organizuara në emër të një lënde të caktuar dhe pasqyrohen në programin lëndor (p.sh. udhëtime në terren), ndërsa disa aktivitete të tjera që mund të jenë më të zgjeruara, organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së departamentit. Programi lëndor (syllabus) i secilës lëndë miratohet nga Senati Akademik dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Rektoratit të Universitetit EPOKA përmes Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ndjek realizimin e aktiviteteve.</p> <p><i>Ref.: Programi lëndor i lëndëve, Anexe të detyruara me tabela përmbledhëse të PS</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në universitet mësohet së Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit organizon udhëtime në terren ose ëorkshope në mënyrë që të mbështesin procesin e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, stafi akademik monitoron me kujdes raste të veçanta dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë sa më herët çështjet problematike të studentëve që mund të ndodhin për arsye të ndryshme. Një shembull mund të jenë studentë me shenja të përparura të çrregullimit të hiperaktivitetit dhe deficitit vëmendjes. Në këto raste, studentëve u ofrohen orë shtesë nga pedagogu.</p> <p>Së dyti, departamenti mbikqyr procesin ku studentët e nivelit master ndihmojnë studentët e ciklit të parë të studimeve në klasa ku ata përballen me vështirësi. Universiteti ofron disa bursa për studentë të suksesshëm të nivelit master të gatshëm për të ndihmuar studentët e ciklit të parë të studimeve për një numër të caktuar orësh në javë në lëndë të caktuara.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti i</p>

<p>shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Inxhinierisë së Ndërtimit ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë së Ndërtimit për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut.</p> <p><i>Ref: Strategjia Kuadër e Universitetit "EPOKA" 2018-2022, Plani strategjik I Departamentit 2017-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Ky vlerësim fillon që në fazën e rekrutimit, nëpërmjet Formularit e Vlerësimit të Leksionit të Hapur (bashkangjitur në RVJ, shtojca 40). Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Inxhinierisë Ndërtimit përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Një nga metodat kryesore, që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri. Pyetësori aktivizohet në sistem një muaj para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon ëorkshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga pedagogë ndërkombëtarë.</p> <p>Sa më sipër rezulton se institucioni vlerëson dhe përmirëson vazhdimisht format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët, si edhe duke reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarët. Studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p><i>Ref. Planet lëndore (syllabusët)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit,</p>



autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <i>Ref. Planet lëndore (syllabuset)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi III.3**  
**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësinë profesionale duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimit dhe shkencor kryhet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka kampusin e tij të ri - përfunduar në vitin 2011 - dhe ka pasur ambientet më moderne që nga fillimi i tij. Administrata ka punësuar një kompani pastrimi që është gjithmonë e pranishme në kampus. Gjithashtu, një ekip me teknikë është i punësuar, që përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambienteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, mirëmbajtjen e mjediseve sportive. <i>Ref.: Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për procesin e mësimit janë të pajisura me pajisjet më moderne, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën moderne etj.  Gjithashtu, studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit kanë mundësinë që të zhvillojnë seancat e tyre laboratorike në një nga laboratorët më modernë të Inxhinierisë së Ndërtimit në Shqipëri duke ofruar mundësinë për të kryer prova dhe të kryejnë kërkime shkencore në të gjitha nëndisiplinat e Inxhinierisë së Ndërtimit. <i>Ref.: Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimit. Universitetit EPOKA i pajis studentët dhe stafin me emaile me baze Google @epoka.edu.al, të tilla si memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom, etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale të Sistemi Interaktiv të EPOKA (EIS), nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me Universitetin. Gjithashtu, përmes sistemit të menaxhimit të të mësuarit LMS çdo pedagog mund të hapë një llogari lënde nga e cila pedagogu ndanë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e shtëpisë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për

	<p>lëndën specifike. Kampusi ka akses në internet në të gjitha ndërtesat dhe tre laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me ëindoës: MS Office, AutoCAD, Adobe, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 e fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench , Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + Vray, 3D-MAX dhe SPSS.</p> <p><i>Ref. shtojcës 42: Infrastruktura në funksion të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit EPOKA. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti EPOKA gjithashtu ka akses në një numër bibliotekash on-line.</p> <p><i>Ref.: Lista e librave/periodikëve shkencorë në bibliotekë</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka ka një fond librash shumë të pasur për secilin nga programet e studimit të ofruar nga Universiteti. Universiteti ofron ambiente komode për lexim dhe sallë studimi për më shumë se 110 studentë dhe pedagogë. Titujt e librave vlerësohen si të mjaftueshëm për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Biblioteka pasurohet çdo vit. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: anglisht, shqip, frëngjisht etj. Librat e blerë janë zgjedhur sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët digjitale e krijuar në 1995, që përfshin më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga printimi në operacione digjitale, për të zgjeruar aksesin e teksteve shkencore në të gjithë botën, si edhe për t’i ruajtur ato për brezat e ardhshëm.</p> <p>Çdo anëtar i stafit të Universitetit EPOKA mund të hyjë në koleksionet e JSTOR duke u futur në <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a> dhe duke kërkuar për materiale.</p> <p>Drejtimesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe shumë të pajisur. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me një adresë e-mail, e cila u ofron atyre mundësi komunikimi në internet, përmes veçorive të postës elektronike <a href="mailto:epoka.edu.al">epoka.edu.al</a> me bazë në Google. Gjithashtu përdoren, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Google</p>



tyre.	<p>Drive and sharing, Google Classroom etj.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimi LMS, pedagogët inkurajohen të përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës LMS Moodle pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p><i>Ref.: Infrastruktura në funksion të programit të studimit.</i></p>			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	<p>Nga vizita në Universitet si dhe nga shqyrtimi i Infrastrukturës në funksion të programit të studimit, konstatohet se stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të brendshëm të komunikimit si p.sh. adresat elektronike të Universitetit “EPOKA”, shkëmbimi i dokumenteve përmes Google Drive, Google Classroom, faqet e internetit të google. Sistemi i brendshëm më i rëndësishëm i komunikimit është ai përmes Sistemit të Menaxhimit të Mësimi, të platformës Moodle, të ofruar nga Universiteti, për të aksesuar dokumentat elektronike dhe profilet e tyre personale të dedikuara.</p>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Në fillim të semestrit të gjashtë, secili student që ka të drejtë të marrë temën e diplomës propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të mbikëqyrësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me zgjedhjen e temës deri në përfundimin e punimit të diplomës</p> <p><i>Ref.: Programet Lëndore të PS</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, Senati Akademik i Universitetit EPOKA ka krijuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Struktura dhe dokumentacioni përkatës është publike në faqen kryesore të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (<a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a>).</p> <p>Struktra kryesore në nivel institucional është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), me nën-njësitë e tij si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,</li> <li>- Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, dhe</li> <li>- Bordi i Provimeve.</li> </ul>

	Struktura dhe funksionimi i KPSC dhe nën-njësive të saj janë përcaktuar në Statutin e Universitetit EPOKA, në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC, dhe në Manualin e Universitetit EPOKA për Sigurimin e Cilësisë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Nga shqyrtimi I rregullores së funksionimit të PS vërehet që Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, ëorkshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. Specifikisht për studentët e rinj, departamenti organizon javën e orientimit në fillim të çdo viti akademik.  <i>Ref.: Plani Strategjik i departamentit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit- si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC)- si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.  Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve ppt, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika laboratorike, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga industria që vizitojnë kampusin, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale vullnetare (p.sh. vlerësimi i dëmeve pas tërmetit), seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor.
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizojnë në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga trajnues ndërkombëtarë, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në Statutin e Universitetit si dhe në Planin Strategjik të Departamentit, stafi akademik i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi dhe stafi mbështetës (koordinatorja e Departamentit, Zyra e Administratorit të Fakultetit, etj.) janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim.  <i>Ref.: Plani Strategjik i departamentit</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie,	GVJ u prezantua me aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja

analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Universitetit dhe Departamenti. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Raportet janë të aksesueshme edhe në faqen e internetit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Universiteti i pajis studentët me Udhëzuesin e Studentëve (Student Guide), i cili informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen e zyrtare të Universitetit.</p> <p>Rregullorja e institucionit/programit parashikon në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatorë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësha specifike e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lenda në lëndë. Në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 5-10 % pjesëmarrja</li> <li>- 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</li> <li>- 20-30 % testimet gjatë vitit</li> <li>- 40-50 % provimi përfundimtar</li> </ul> <p><i>Ref.: Udhëzuesi i Studentëve, Syllabuset e Lëndëve të PS.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxëniet të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj.</p> <p>Syllabuset e lendeve janë të publikuara në Sistemin Interaktiv EPOKA (EIS). Përgjatë vizitës në Universitet u konstatua lehtësia e marrjes së informacionit nga studentët.</p> <p><i>Ref.: Sistemi Interaktiv EPOKA; <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/56/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/56/program</a></i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve në programin studimor, si dhe dhe takimit me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes 11 formave kryesore: 1) detyrë shtëpie, 2) provim i ndërmjetëm (midterm), 3) prezantim 4) projekt 5) kuiz 6) laborator 7) projekte laboratorike / praktike, 8) studim rasti, 9) projekte semestrale, 10) provim përfundimtar 11) pjesëmarrje aktive.</p> <p><i>Ref.: Syllabuset e Lëndëve të PS.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore të PS, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet pergjatë gjithë semestrit akademik.</p> <p>Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet; provimet e ndërmjetëm- midterm (java e 8 e semestrit) dhe provimet përfundimtare (përfundimi i semestrit, javët 15 dhe 16 e semestrit). Përjashtim këtu bën semestri pranverë 2019-2020, pergjatë të cilit testimi i ndërmjetëm është bërë në format projekti/detyre, dhe provimet përfundimtare janë planifikuar të shtrihen në 4 javë.</p> <p>Ndërmjet tyre, studentët testohen me teste, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Nga vizita në Universitet konstatohet qe, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, notat futen në mënyrë elektronike në Sistemin Interaktiv EPOKA (EIS).</p> <p>Bordi i Provimeve, nën varësinë e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), menaxhon procesin e vlerësimit të cilësisë së provimeve. Kjo procedure zhvillohet pas finalizimit të notave, për cdo semestër, me një përzgjedhje rastësore nga sistemi.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Provimet vlerësohen nga pedagogu/titullari i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike (p.sh. Introduction to Civil Engineering, Civil Engineering drawing). Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mesimore, në disa raste edhe nga një pedagogu i ftuar.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet kodifikimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga disa vëzhgues të emëruar nga fakulteti, dhe një sistem kamerash sigurie të cilat sigurojnë evidenca në raste të vecanta parregullsie (sipas rregullores së provimeve në fuqi, bashkangjitur në shtojcat e RVB).</p>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogeve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.</p>

përmirësohet në të ardhmen.									
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Universiteti, nëpërmjet rregullores "Për disiplinën e studentëve", dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor programin Turnitin si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për detyrat me shkrim.								
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e perfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit interaktiv EIS, në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar.  Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.  <i>Ref.: Rregullore "Për Studimet dhe Provimet në ciklin e parë të studimeve"</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i rregullores "Për studimet dhe provimet në ciklin e parë të studimeve", si dhe nga vizita në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në Zyrën e Regjistrimit me anë të një formulari të veçantë, brenda një jave pas shpalljes së notave përfundimtare.								
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura mbi ankimimet/kërkesat është e shkruar në "Udhëzuesi i Studentëve". Pedagogu përkatës vlerëson ankimimin dhe harton një raport. Raporti dhe formulari i kërkesës për ankesë të notës i dërgohen Dekanatit, i cili më pas merr vendimin përfundimtar. Zyra e Regjistrimit ndjek, dokumenton dhe arkivon procedurën e përgjithshme.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.  Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë-kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca



	<p>studentore, etj.</p> <p><i>Ref.: Kurrikula e PS</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).</p>	<p>8.8% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (të tilla si Hyrje në Kompjutera dhe Programim, lëndë të gjuhëve të huaja, etj.)</p> <p><i>Ref.: Kurrikula e PS</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde përmbledhen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. Në nivel institucional, kjo rregullohet përmes direktivës "Për funksionimin e bordit të provimit".</p> <p><i>Ref. Direktiva "Për funksionimin e bordit të provimit"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Leksionet zhvillohn kryesisht duke kombinuar metodën tradicionale të shkrimit në tabelë me prezantime interaktive ppt. Këto shënime dhe përmbledhje leksionesh ndahen më studentët javë pas jave.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe në praktikat profesionale.</p> <p><i>Ref.: Syllabuset e Lëndëve të PS.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p><i>Ref.: Kurrikula e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndër-kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, me anë të Dekanatit të Studentëve, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht.</p> <p><i>Ref.: Rregullore e zyrës/njesisë së këshillimit dhe karrierës</i></p>

<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. Ndër marrëveshjet më aktive është ajo me Universitetin Politeknik të Barit, Universiteti Teknik "Gheorghe Asachi" në Iasi, etj. Stafi Akademik dhe studentët e universiteteve partnere shkëmbehen rregullisht çdo semestër. Ndër studentët përfitues të programit të mobilitetit ishte Eraldo Braka, student i vitit të 3, me një semestër të zhvilluar në Universitetin Teknik "Gheorghe Asachi" në Iasi, Rumani.</p> <p><i>Ref.: Tabela përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p><i>Ref: <a href="http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html">http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Informacioni dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato tek studentët në fillim të semestrit.</p> <p>Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Ref.: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre bachelor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p><i>Ref: <a href="http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html">http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html</a></i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/</p>	<p>Nga vizita në universitet dhe shqyrtimi I syllabusit përkatës mësohet që stafi akademik përgjegjës për provimin e përgjithshëm përfundimtar është këshilltari i studentëve të vitit të tretë. Pedagogu përgjegjës organizon dhe ndjek orarin e konsultimit të realizuar nga pedagogët e secilës</p>



diplomave.	nëndisiplinë.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Studentët e masterit, të punësuar si personel mesimor ndihmës (asistent mësimore), asistojnë dhe ndihmojnë studentët e programit bachelor.  <i>Ref.: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e projektit të diplomimit dhe e shpërndajnë atë tek studentët në fillim të semestrit. Studentët përzgjedhin lektorin udhëheqës sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Udhëheqësi vendos nëse studenti është gati të paraqesë punën e tij / saj para një komisioni.  <i>Ref.: Programet lëndore</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga pedagogu përgjegjës për koordinimin e provimit/udhëheqësi i projektit diplomës.  <i>Ref: <a href="http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html">http://ce.epoka.edu.al/home-comprehensive-exam-379-1922.html</a></i>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS dhe notën mesatare mbi 2.0/4.0, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin.  Zyra e Regjistrimit të Universitetit pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MASR.  <i>Ref.: Rregullore për Studimet dhe Provimet në ciklin e parë të studimeve, Rregullorja Themelore e Universitetit EPOKA, Rregullore e diplomimit</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët mund ta aksesojnë programin e zhvilluar në cdo moment, nëpërmjet sistemit interaktiv EIS. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të zhvilluar.  <i>Ref. Guida e Studentit</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, leshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.  <i>Ref.: Rregullore e diplomimit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës III	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Refruar RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në Universitetin Epoka mblidhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe ato të personelit ndihmës. Në lidhje me mbledhjen e këtyre të dhënave Universiteti "EPOKA", nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, shpërndan tek stafi një formular, i cili kompozohet sipas direktivave të Komisionerit Publik "Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Ky formular plotësohet nga çdo anëtar i stafit. GVJ u informua se, në fillim të çdo viti akademik, Zyra e Burimeve Njerezore, bazuar në propozimet e departamenteve dhe fakulteteve organizon ndarjen e stafit akademik, stafit ndihmës dhe atij mësimor. Ngarkesa mësimore e gjithë stafit rregullohet nga Direktiva e Universitetit "EPOKA" "Për ngarkesën mësimore". GVJ e konsultoi këtë dokument dhe kërkoi informacione më të hollësishtme gjatë takimit me stafin, ku mësoi se ngarkesa diskutohet në departament. Gjatë diskutimit synohet dhe dakordësohet për balancimin e ngarkesës në të tre ciklet.</p> <p>Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhet në dosjet e personelit (formati hard copy dhe formati dixhital). Dosja dixhitale ndodhet në sistemin e menaxhimit të informacionit. Dosjet hard copy u konsultuan nga GVJ gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerezore. GVJ konstatoi që dosjet përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara dhe vetë të dhënat janë të përditësuara.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ gjeti që procedurat e Rekrutimit te Stafit ne Universitetin "EPOKA" rregullohen me Rregulloren e brendshme "Për Rekrutimin e Stafit" të Universitetit "EPOKA" dhe në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ligjet kombëtare shqiptare që disiplinojnë rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si: Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodi i Punës i Shqipërisë dhe Ligjet e tjera që kanë një efekt në këtë proces. Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerezore GVJ u interesua të njihej konkretisht me zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe gjeti që ato ishin kryer konform akteve ligjore e nënligjore.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ i konsultoi të gjitha kriteret dhe procedurat e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit të shenjura në dokumentat bazë si: Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Statutin e Universitetit Epoka, Rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës e Inxhinierisë etj dhe i gjeti ato të hartuara në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe të zbatuara gjatë gjithë aktivitetit për rekrutimin e personelit. Këto akte ishin bërë publike edhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="http://epoka.edu.al">http://epoka.edu.al</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi fillimisht RVB ku thuhet se: Procesi i rekrutimit të stafit bazohet në dispozitat e parashikuara në Rregulloren "Për Rekrutimin e Stafit" të Universitetit dhe realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel, të cilat i paraqiten Zyrës së Burimeve Njerëzore nga të gjitha departamentet dhe njësitë kryesore. Këto kërkesa miratohen me vendim të Bordit të Administrimit“. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit ndiqej me rigozitet e transparencë. E gjithë procedura ishte bërë publike në faqen zyrtare, ndërkohë që realizimi i saj ishte i protokolluar. Protokollu përmbante: ftesën për kokurim, dokumentat e paraqitura nga kandidati, shqyrtimin e dosjes nga Komiteti Shkencor i Njësisë, intervistën paraprake me kandidatët, leksionet e hapura, "Formularin e Rekrutimit të Stafit Akademik Universitar "EPOKA", vlerësimin përcjellë rektoratit si dhe vendimin e Bordit Administrativ për punësimin e kandidatit. GVJ gjykon që kjo procedurë garanton rekrutimin e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e PS.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet e punës të personelit akademik të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Ai i gjeti këto ambiente të përshtatshme dhe shumë funksionale për kryerjen e detyrave mësimore e kërkimoro shkencore. Kjo u pohua edhe nga pjesëtarët e personelit në takimin që GVJ organizoi me ta.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, GVJ konstaton që Universiteti "EPOKA" organizon vazhdimisht trajnime për stafin e tij akademik me qëllim aftësimin profesional të stafit, në përputhje me përcaktimet e Statutit të tij dhe të standardeve ISO. Të gjitha trajnimet ishin të afishuara në faqen zyrtare.</p> <p>Përmbajtja e tyre lidhej me nevojat e identifikuar të stafit akademik.</p>

	<p>Për më tepër, stafi akademik inkurajohej shumë për të marrë pjesë në projekte të shkëmbimit të stafit “Erasmus+” me universitete të tjera partnere. Anëtarë të stafit na thanë që nëpërmjet këtyre pjesmarrjeve ata kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe strategjitë e zhvilluara në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë në Europë dhe jashtë saj.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ gjen që në Universitetin Epoka trajnimet e stafit përbëjnë një pjesë solide të Planit Strategjik që zbatohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë në bashkëpunim të ngushtë me zyrat e tjera konkretisht Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve etj organizon trajnime për stafin. Këto trajnime synojnë zhvillimin e mëtjshëm profesional të personelit. Disa nga trajnimet e realizuara kanë qenë për arsimin dixhital.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënjes e mësimnxënjes si dhe aktiviteteve kërkimore, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kishin organizuar workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi ku ishin ftuar trajnues ndërkombëtarë. Në takimin me antarë të personelit akademik, GVJ u interesua për stadin e zhvillimit të mësimin online në këtë institucion. Në përgjigje të këtij interesimi ata u informuan për platformën që përdorte ky institucion si dhe për objektivat në lidhje me përsosjen e mëtjshme të kësaj metode mësimdhënje.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni dëshmon angazhimin e të gjitha burimeve njerëzore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit Bachelor. Konkretisht, për PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” pedagogët kryesorë të lëndëve të ofruara në kurikulë zotërojnë të paktën kualifikimin "Master i Shkencave" (nga 7 anëtarë 5 ishin me gradën shkencore doktor) sipas nenit 59, pika 6 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Po ashtu, sipas CV-ve të tyre ata kanë një përvojë disa vjeçare si Asistentë Akademikë në fushën specifike të lëndës që zhvillojnë. GVJ u informua që Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka vënë si objektiv që në një kohë të shkurtër i gjithë stafi akademik të zotërojë të paktën gradën Doktor. Me përmbushjen e këtij objektivit departamenti e përmirëson më tej imazhin e tij, çfarë ndikon jo vetëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënjes e mësimnxënjes apo të aktivitetit shkencor por edhe në tërheqjen e kontigjenteve më cilësore për rregjistrimin në këtë PS.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatese.	Si nga paraqitja në RVB ashtu edhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që Universiteti Epoka vë në dispozicion ambiente shumë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të PS. Auditoret, laboratorët, biblioteka dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. Studentët ishin të pajisur me kartë studenti dhe kishin akses gjatë gjithë kohës për t'i përdorur si ambientet ashtu edhe teknologjinë mësimore të vendosur në këto ambiente. Theksojmë se në kuadër të situatës që lidhet me COVID 19 këto ambiente ishin dizenuar për t'i pritur studentët në respektim të protokollit të posaçëm të nxjerrë nga autoritetet shtetërore.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GVJ gjeti paisje të tilla si: tabelat interaktive, projektuesit video, kompjuterat dhe internetin të cilat ishin funksionale. Po ashtu laboratorit i inxhinierisë së ndërtimit ishte i pajisur me të gjitha pajisjet dhe instrumentet që nevojiteshin për të realizuar laboratorët e lëndëve profesionale. Edhe laboratorët e lëndëve plotësuese si informatikës apo gjuhëve të huaja ishin të pajisur me të gjitha pajisjet dhe softet për zhvillimin e procesit mësimor konform programit.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konstatoi që për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” institucioni kishte vënë në dispozicion të procesit mësimor e kërkimor shkencor 4 laboratorë kompjuterikë, 2 laboratorë elektronikë si dhe laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit. Në të gjitha mjediset laboratorike ishin instaluar pajisjet e duhura dhe softet e përshtatshme në përputhje me realizimin e të gjitha objektivave të procesit mësimor e kërkimor shkencor. Në RVB listohen të gjitha shërbimet e ofruara në këto mjedise si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbime Mësimore (Tumitin, Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS), Sistemi i Automatizimit të Bibliotekave (Koba), DSpace).</li> <li>• Shërbimet e Google (Webmail (llogari Google), Google Classroom)</li> <li>• Sistemi i Informimit të Arsimit (Kurrikula)</li> <li>• Smart Card</li> <li>• Help Desk</li> <li>• Programe kompjuterike</li> <li>• Interneti (Wireless, me fije, Sinjal dixhital)</li> <li>• Sistemi Interaktiv EPOKA (EIS)</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe	Në universitetin Epoka, GVJ gjeti 4 laboratore të teknologjisë së informacionit të pajisura me programe profesionale të cilat ofronin shërbime sipas kërkesave specifike të programit. Shërbimet bazë janë



profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	përmendur më lart.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të përshtatshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar RVB si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se për programin mësimor Bachelor në „Inxhinieri Ndërtimi“ mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe njëkohësisht të posaçme si për zhvillimin e praktikave ashtu edhe të aktiviteteve të tjera. Këtu përfshihen të gjitha ambientet laboratorikë si dhe të gjitha shërbimet e ofruara. Në këto ambiente konkretizohen njohuritë teorike dhe zhvillohen aftësitë praktike të studentëve. Vetë studentët u shprehën që ata ndjehen të akomoduar mjaft mirë në mjediset ku kryenin aktivitetin praktik. GVJ mësoi që universiteti kishte marrëveshje me kompani vendase për të zhvilluar praktikën verore të studentëve si dhe me kompani të huaja për të shkëmbyer përvoja praktike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ raporton që universiteti Epoka vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën mësimore me një kapacitet prej 110 vendesh dhe me një sipërfaqe prej rreth 400 metra katrorë dhe një fond prej 25000 librash. Kjo bibliotekë kishte një fond të madh librash të skeduar dhe të modular sipas programeve të studimit që ofron institucioni. Biblioteka ofronte si shërbimin me personel ashtu edhe shërbimin online. Personi i ngarkuar me bibliotekën ishte i gatshëm për t'i ndihmuar të interesuarit për të gjitha shërbimet.  Për të siguruar një shërbim në nivelin e standarteve ndërkombëtare institucioni ishte antarësuar në Unionin e Bibliotekave të Ballkanit qysh nga 29 korriku i vitit 2009. Pyetjes nëse krijoheshin probleme lidhur me postet e punës në bibliotekë punonjësi i ngarkuar me bibliotekën iu përgjigj se numri i vendeve ishte i mjaftueshëm, ndërsa orari i frekuentimit ishte funksional.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit	Gjatë vizitës në institucion dhe konkretisht në ambientet e bibliotekës GVJ konstatoi që ajo ishte e paisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore të skeduar sipas programeve të studimit. Për një shfrytëzim sa më profesional të fondit, studentëve u vihej në dispozicion klasifikimi LC nëpërmjet të cilit ata udhëzoheshin për të gjetur materialin e dëshiruar. Në pyetjen që GVJ u drejtoi studentëve lidhur me shërbimin e bibliotekës, përgjigja ishte që ata ishin të



të studimit.	kënaqur me këtë shërbim.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që ky kriter përmbushej në mënyrë mjaft të kënaqshme.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në interesimin e tij për paisjen e bibliotekës së institucionit GVJ mësoi që kjo bibliotekë ishte antarësuar në bibliotekën dixhitale JSTOR, e cila ka një fond prej rreth 2000 revistash akademike. Si rezultat i këtij antarsimi, përdoruesve të bibliotekës së universitetit Epoka i ishin vënë në dispozicion softet për aksesim në gjithë fondin disponues të JSTOR. Po kështu edhe aksesimi në fondin fizik të bibliotekës realizohej me anën e kompjuterave nëpërmjet programit të dizenuar për këtë qëllim.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nëpërmjet RVB-së GVJ ishte informuar paraprakisht për rekomandimet që i ishin lënë institucionit nga akreditimi i mëparshëm. Në interesimin për plotësimin e rekomandimit lidhur me pasurimin e bibliotekës me literaturën e nevojshme në gjuhën shqipe GVJ mësoi për përmbushjen e këtij rekomandimi me titujt e blerë. Në këtë kuadër GVJ kërkoi të njihet me planin për shtimin e zërave të literaturës në bibliotekë si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të PS. Punonjësi i ngarkuar me bibliotekën sqaroi se si funksionon procedura e pasurimit (blerjet dhe dhurimet) si dhe ajo e përditësimit. Ai tha që biblioteka, për pasurimin dhe përditësimin e literaturës ndodhej nën presionin e kërkesave të pedagogëve dhe studentëve, kështu që vazhdimisht duhej të pasurohej për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi që orari i kohës së punës së bibliotekës ishte i afishuar. Biblioteka ishte e hapur në ditët e javës (e hënë deri e premte) nga ora 08.30 deri në orën 12.30 paradite dhe nga ora 13.30 deri në orën 17.30 pasdite. Orari i ditës së shtunë ishte 09.00 deri 13.00. Nga pyetja që u bëri studentëve lidhur me kohën e punës së bibliotekës GVJ mësoi se ata nuk kishin asnjë ankesë lidhur me shërbimin dhe kohën e punës të bibliotekës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët	GVJ konstaton që Universiteti Epoka disponon system të menaxhimit të informacionit me të cilin administron gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim. Ky sistem

dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	emërtohej ishte zhvilluar nga Zyra e Koordinimit të Informacionit dhe Komunikimit Teknologjik (IT) në Universitetin "EPOKA". Sistemi aksesohet nga përdoruesit nëpërmjet llogarisë së tyre zyrtare të postës elektronike. GVJ kërkoi demonstrimin praktik të këtij sistemi duke u informuar në detaje për funksionimin e tij. GVJ u informua që institucioni planifikonte që këtë sistem ta përmirësonte vazhdimisht me module të reja në përgjigje të nevojave të universitetit dhe gjithë përdoruesve të tij.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua se përdoret i njëjti sistem menaxhimi. Ky sistem u mundëson personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe partnerëve aksesim funksional për të menaxhuar aktivitetin e tyre në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të institucionit. Koordinimi i përgjithshëm i aktivitetit për personelin bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e cila evidentonte ecurinë dhe përcaktonte pozicionin e punës për stafet përkatëse.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton që vetë kodimi i EIS me postën elektronike e profilizon aksesin tek ky sistem si të dedikuar. Dukeqenëse informacioni ruhet në një bazë qendrore të dhënash edhe stafi edhe studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe atë që lidhet me programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të këtij sistemi dhe konkludon që ai është mjaft i dobishëm për informimin, organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve si të studentëve ashtu edhe të stafit aktiv në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi".
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua për integrimin në sistemin e menaxhimit të institucionit EIS të platformës Google për arsim. Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit dhe studentëve. Për këtë përdoruesit (personeli dhe studentët) ishin të pajisur me një postë elektronike në domenin epoka.edu.al që ishte një llogari në Google. Gjithashtu institucioni përdorte platformën "Google Classroom" për të aksesuar, koordinuar dhe organizuar materialet mësimore të lëndëve në Cloud.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	GVJ konstaton që sistemi EIS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Kështu nëpërmjet tij monitorohet frekuentimi i studentëve, llogaritjet nota përfundimtare, njoftohet stafi akademik dhe administrativ për të drejtën e hyrjes në provim të studentëve etj. Ky sistem automatizon edhe procesin e plotësimit të kërkesave të studentëve për dokumenta të caktuara duke inicuar dhe ndjekur procesin deri në fund.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi faqen zyrtare në internet të institucionit dhe gjeti që informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të Universitetit Epoka publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë ku njëra është

internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	gjuha angleze dhe gjuha tjetër është gjuha shqipe. Në këtë faqe publikohen edhe informacione të dedikuara njësisive kryesore e atyre bazë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.6**  
**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton që Universiteti Epoka ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit pasi kalon nëpër disa faza diskutimesh ku paraqiten nevojat dhe shqyrtohen mundësitë. Fillimisht nevojat paraqiten duke plotësuar formularë të standartizuar të cilat dërgohen në njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera. Në këto formularë, mbështetur në planet strategjike të zhvillimit, listohen nevojat për t'ia dërguar rektoratit. Ky i fundit merr vendimin për t'ia dërguar Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar. GVJ gjykon që ky raport merr në konsideratë plotësimin e nevojave edhe për mbarëvajtjen e PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e	GVJ u informua që auditimi i përvitshëm, vlerësimi dhe dokumentimi i përgjithshëm i gjendjes financiare dhe efektivitetit financiar për universitetin Epoka bëhet nga shoqëria aksionere “Turgut Ozal Education sh.a”. Raporti i të gjitha gjetjeve nga auditimi gjendej në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të “Turgut Ozal” ndërkohë që një kopje e tij ndodhej edhe në Zyrën e Financave të Universitetit. Duke parë ecurinë e përgjithshme të

burimeve financiare.	programit të studimit bachelor në “Inxhinierinë e Ndërtimit” dhe duke ndjekur informacionet e dhëna gjatë vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni zotëron burimet e nevojshme financiare për ta mbështetur këtë PS.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Si më sipër GVJ konkludon që ky kriter përmbushet.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Edhe në këtë rast GVJ shqyrtoi raportet zyrtare si: Pasqyrën e të Ardhurave dhe Pasqyrën e Shpenzimeve dhe mësoi që kompania ka bilanc financiar pozitiv, çfarë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ekzistencën e kapaciteteve financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen. Për informim më të plotë GVJ konsultoi edhe faqen zyrtare në adresën:  <a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPOR_TI_VJETOR">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPOR TI VJETOR</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar RVB dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ është informuar mbi politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Në konkluzion ai gjen që këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit.  Konkretisht Universiteti Epoka e ka rregulluar pranimin e studentëve në PS bazuar në kuotat e propozuara nga Bordi i administrimit. Pranimi realizohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit,

	<p>Sportit dhe Rinisë dhe Rregulloreve të Universitetit Epoka. Ecurinë e studentëve gjatë gjithë kohës së studimit, në të gjitha programet që ofron, Institucioni e ndjek nëpërmjet EIS (Sistemit të Interaktiv Epoka).</p> <p>GVJ e ndoqi konkretisht menaxhimin e të dhënave nëpërmjet këtij sistemi dhe konstaton që ai është i drejtë, funksional dhe efektiv.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e politikave dhe procedurave për pranimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve, GVJ gjykon që ato garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Të gjithë ata që kanë aplikuar për programet e studimit në Universitetin Epoka dhe fitojnë të drejtën e studimit rregjistrohen si studentë zyrtarë dhe u nënshtrohen njëlloj të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ky status. GVJ konstaton që në këtë institucion, si të drejtat ashtu edhe detyrimet janë të njëjta për të gjithë studentët që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ i konsultoi procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve, ato të përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit dhe gjykon që ato janë të aksesueshme dhe të kuptueshme nga publiku. Procedurat deri në rregjistrim janë procedura konkurruese të cilat gjenden në faqen zyrtare të universitetit Epoka.</p> <p>Ecuria e studentëve që nga momenti kur ata marrin statusin e studentit dhe deri në diplomim ndiqet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit EIS. Ky sistem funksiononte pa probleme. Ai garantonte si informim të shpejtë ashtu edhe të kuptueshëm e të saktë. Sidoqoftë e gjithë ecuria e procesit, përveçse në faqen e internetit, ndiqej e rregullohej edhe nga zyrat përkatëse duke filluar me Zyrën e Pranimit deri tek Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të diplomuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Është e njohur që kriteret për pranimet e studentëve në shkollat e larta hartohen duke iu referuar Urdhërit të MARS. Bazuar në këto Udhëzime, Universiteti Epoka ka hartuar kriteret specifike për pranimin e studentëve në këtë Institucion si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studentët duhet të zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme ose diplomë ekuivalente me të.</li> <li>2. Të kenë notën mesatare minimale 7</li> <li>3. Të kenë certifikim të gjuhës angleze në nivelin B1 nga provimet e shpallura në kriteret e pranimit si: Cambridge, IELTS, TOEFEL etj.</li> </ol> <p>(Studentët e japin provimin e gjuhës angleze edhe në ambientet e Universitetit Epoka).</p> <p>GVJ konstatoi që i gjithë informacioni mbi kriteret e pranimit</p>



	<p>ndodhet në faqen zyrtare të Universitetit Epoka.</p> <p>Për pranimin e studentëve të huaj ndiqet e njëjta procedurë me specifikën që ata duhet të ekuivalentojnë diplomën e shkollës së mesme si dhe të noterizojnë dokumentat shtesë. Për të gjithë ata që mësimin në shkollën e mesme e kanë bërë në anglisht nuk kërkohet certifikatë provimi për nivelin B1.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua që udhëzimin e publikut dhe të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në ambientet e universitetit e organizon dhe e kryen Zyra e Pranimeve. Maturantët ftohen në kampusin e Universitetit "EPOKA", ku ata mund të marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Më pas ata marrin informacione edhe nga pedagogët përkatës të PS.</p> <p>Edhe pas kësaj të interesuarit mund t'i konsultojnë si kriteret e pranimit ashtu edhe të drejtat dhe detyrat e tyre si studentë në faqen zyrtare të institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Përveç informimit të përgjithshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e cila është e aksesueshme për gjithë të interesuarit, informacion i plotë dhe i hollësishëm lidhur me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin studenti i merr edhe përmes Udhëzuesit të Studentit që botohet çdo vit dhe i jepet çdo studentit gjatë procesit të regjistrimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konsultoi RVB dhe, gjatë vizitës në institucion, mësoi për punën që bëhet në informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë kuadër konstatohet që sipas direktivave dhe rregulloreve çdo student, duke përfshirë edhe studentët e huaj, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit. Në takimin me studentët GVJ mësoi që ata kishin informacionet e nevojshme lidhur me njohjen e studimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e</p>	<p>GVJ konstaton që në Universitetin Epoka studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky konstatim konfirmohet si nga gjetjet në RVB ashtu edhe informacionet nga vizita</p>



studimit.	në institucion. Përveçse në dokumentacionin ligjor të Universitetit kriteret dhe procedurat e vlerësimit jepen edhe në syllabuset e lëndëve.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Edhe për këtë kriter vlen i njëjti pohim si më sipër me specifikën që me përfundimin e studimeve në Bachelor “Inxhinieri Ndërtimi”, kriteri i notës mesatare mbi 3 i klasifikon studentët në ata që bëjnë tezë diplome dhe na ata që i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm. Para mbylljes së studimeve studentët e dinë se në cilin grup përfshihen.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Për të gjithë ata që aplikojnë për një program studimi në Universitetin Epoka ekziston mundësia e informimit paraprak në faqen zyrtare në internet. Nga kjo faqe të interesuarit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm. Përpos kësaj, Zyra e Pranimit organizon Programin e Planifikimit të Karrierës për maturantët e shkollave të mesme. Maturantët ftohen në kampusin e Universitetit "EPOKA", ku marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm nga Zyra e Pranimeve, aplikantët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar nga pedagogët përkatës. Informimi vazhdon edhe me studentët e viteteve të para me aktivitete që organizohen nga fakulteti në bashkëpunim me departamentin. GVJ i pyeti studentët si e kanë gjetur këtë PS tek Epoka dhe ata u përgjigjën që janë informuar nëpërmjet faqes zyrtare, kontakteve me të njohur dhe pjesmarrjes në aktivitetet informuese të institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” bëhet më së pari nëpërmjet faqes në internet të departamentit, vazhdon me seancat orientuese që synojnë të informojnë studentët e viteve të para, dokumentohet në Udhëzuesin për Studentin që publikohet çdo vit dhe realizohet në mënyrë konvejer nëpërmjet sistemit interaktiv Epoka.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nëpërmjet RVB dhe vizitës në Institucion GVJ u informua mbi Kurikulën dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Këto materiale u vihen në dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon	GVJ konstaton se përmbushja e këtij kriteri realizohet nëpërmjet

studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	aktivitetit të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar. Referuar RVB, kjo zyrë edhe e trajnon edhe e mbështet studentin në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato. Ajo disponon edhe vlerësimet e studentëve për praktikat që ata kryejnë në ndërmarrjet bashkëpunuese.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në universitetin Epoka studentët e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. GVJ konstaton se studentët i konsultojnë të gjithë burimet e informacionit. Në takimin me ta, studentët demonstrojnë njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është i plotë në Sistemin Interaktiv Epoka (EIS) i cili njihet mirë nga studentët dhe përdoret në çdo kohë e lehtësisht prej tyre pavarësisht nga distanca.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>							
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>							
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>						
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>Gjatë konsultimit me RVB dhe vizitës në Institucion GVJ u informua që statistikat për numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar i rapotoheshin 4 herë në vit Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nga Zyra e Regjistrimit të Universitetit. Po ashtu institucioni hartonte këto lista edhe për Qendrën Kombëtare Arsimore (QEK) edhe si të dhëna për të përmbushur procedurën të brendshme. Këto lista gjendeshin në Sekretarinë Mësimore të institucionit.</p> <p>GVJ vizitoi zyrat e sekretarisë mësimore ku vëzhgoi regjistrin themeltar dhe regjistrin e ecurisë së studentëve. Gjithashtu vëzhgoi disa dosje studentësh.</p> <p>Numri i studentëve në këtë program studimi ka qenë në tre vitet e fundit si më poshtë:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Viti akademik 2017-2018</td> <td>32 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2018-2019</td> <td>23 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2019-2020</td> <td>31 studentë</td> </tr> </table>	Viti akademik 2017-2018	32 studentë	Viti akademik 2018-2019	23 studentë	Viti akademik 2019-2020	31 studentë
Viti akademik 2017-2018	32 studentë						
Viti akademik 2018-2019	23 studentë						
Viti akademik 2019-2020	31 studentë						

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Këto statistika ndodheshin tek Zyra e Rregjistrimit. Me këto statistika kjo zyrë përgatiste Raportin që i dërgohej MARS dhe raportin vjetor të institucionit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore GVJ i konsultoi të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. GVJ u informua që, duke filluar nga semestri i parë deri në diplomim, çdo notë e studentëve regjistrohej në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre. Ai mësoi gjithashtu se për secilin student sistemi llogarit mesataren semestrale dhe mesataren kumulative, e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi rezultatet pozitive dhe negative të studentëve. Këto informacione të hollësishme ndihmojnë në vendime të ndryshme që lidhen me diplomimin e studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në takimin që pati GVJ me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) kërkoi që të demonstrohej konkretisht funksionimi i Sistemit Interaktiv Europa (EIS). Gjatë demonstrimit GVJ konstatoi që sistemi është funksional, i sigurtë dhe të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në plotësim të direktivave institucionale, në Universitetin Epoka përgatiten raporte periodikë për studentët që vijnë dhe për ato ekzistues, në të cilët formatohen edhe profilet e studentëve lidhur me cilësinë në hyrje dhe atë në dalje. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar ndjek në vazhdimësi edhe të diplomuarit duke u informuar për karrierën e tyre dhe ndikimin që kanë patur studimet në Universitetin Epoka në zhvillimin e karrierës së tyre. GVJ konstaton që këto të dhëna ndikojnë në marrjen e masave sa më efektive për të rritur cilësitë e kontigjentëve të diplomuar nga ky universitet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e</p>	<p>GVJ konstaton që universiteti Epoka ka realizuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet</p>

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>vendimmarrëse e këshilluese. Konkretisht në këtë institucion funksionon Këshilli i Studentëve, të drejtat dhe detyrimet e të cilit bazohen në Legjislacionin Shqiptar si dhe në rregullat dhe rregulloret e Universitetit "EPOKA". Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre edhe në organet e mëposhtme të Institucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senati Akademik</li> <li>• Këshilli i Etikës</li> <li>• Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë</li> <li>• Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton që bazuar në Statutin e Universitetit "EPOKA", studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në Universitetin "EPOKA" përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.</p> <p>Në zbatim të nenit 15, pika 4 të Statutit të Universitetit "EPOKA", Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Parë i Këshillit të Studentëve janë anëtarë të Senatit Akademik.</p> <p>Në zbatim të nenit 29, pika 2 të Statutit të Universitetit "EPOKA", Zëvendëskryetari i Këshillit të Studentëve për çështje të etikës është anëtar i Këshillit të Etikës.</p> <p>Në mbështetje të nenit 34, pika 2 të Statutit të Universitetit "EPOKA", dy studentë të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve janë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët.</p> <p>Në zbatim të nenit 35, pika 8 të Statutit të Universitetit "EPOKA", Zëvendëskryetari i Këshillit të Studentëve për çështje të sigurimit të cilësisë është anëtar i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Modalitetet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Studentëve, si dhe ato për organizimin dhe funksionimin e tij, përcaktohen në nenin 118 të Statutit të Universitetit "EPOKA".</p> <p>Përmes anëtarësimit të përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshillin e Etikës si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve studentë në mbledhjet e këtyre organeve, sigurohet që përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje dhe çështje që i përkasin procesit akademik është efektive dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ konstaton që institucioni e merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit kryesisht gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit si kurikulë dhe si syllabuse. Në takimin me studentët ata u shprehën për konsiderimin e mendimit të tyre në ngarkesën e lëndëve si anglishtja psh. Ata u shprehën gjithashtu se ngarkesa e tyre ishte e përballeshme nqs puna e tyre do ishte sistematike.</p>

mëparshme.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ gjykon se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në Universitetin Epoka garantohej nëpërmjet organizimit të tyre në Këshillin e Studentëve dhe përfaqësuesve në organet e rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senati Akademik</li> <li>• Këshilli i Etikës</li> <li>• Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë</li> <li>• Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët</li> </ul> <p>Kjo përfshirje, siç doli edhe nga takimi I GVJ me përfaqësues të tyre ka ndikuar pozitivisht në strukturimin e kurikulës dhe syllabuseve të lëndëve,</p>								
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se u është mundësuar të japin mendime mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit të tij dhe reflektimit nga ana e institucionit përkatësisht njësisë dhe pedagogut përgjegjës. Studentët treguan rastin e një pedagogeje, e cila pas ankimit të studentëve ishte larguar nga procesi i mësimdhënjes.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi informacione më të detajuara lidhur me procedurat dhe njësitë për informimin e studentëve dhe shërbimet për to në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të Universiteteve. Në përgjigje të këtij interesimi Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit na informuan hollësisht lidhur me kërkesën tonë.</p> <p>Ata thanë që informacionet bazë studentët i merrnin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara. Kështu Zyra e Rregjistrimit, Këshilltari Akademik, Dekani i Studentëve, Sekretaria mësimore, Zyra e Planifikimit të Karrierës e Studentëve të Diplomuar etj janë në funksion të informimit e ofrimit të shërbimeve</p>



	për studentët. Në takimin me studentët, GVJ i pyeti ata se sa të informuar dhe të përkujdesur ndjeheshin gjatë periudhës së studimeve dhe përgjigja e tyre ishte se ndjeheshin vërtet të kënaqur.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që në Universitetin Epoka është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike. Studenti informohet në system konvejer dhe shërbehet sa herë ai e kërkon shërbimin.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstatoi që në Universitetin Epoka Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar (ZPKSD) kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Duke qenë njësia që mban lidhje të vazhdueshme me botën e biznesit ajo i evidenton dhe i analizon kompanitë e fuqishme të biznesit në kërkesat që ato kanë dhe në nevojat e tyre për profesionistë. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët në mënyrë periodike që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Duke ndërmjetësuar interesimin dhe potencialet e të dyja palëve ajo realizon si kërkesat e tregut të punës ashtu edhe punësimin e studentëve të diplomuar. Rezultati i aktivitetit të ZPKSD shihet si tek shkalla e lartë e punëzënjes së diplomantëve (mbi 75%) ashtu edhe tek imazhi i mirë që ka krijuar institucioni në pohimin “Po studiove tek Epoka nuk ngelesh pa punë”.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri një rol parësor kishte ZPKSD. GVJ u informua që kjo zyrë mbledhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të PS Bachelor në „Inxhinieri Ndërtimi“. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion si studentëve po ashtu edhe organeve e autoriteteve mbështetur në kërkesën e tyre të drejtpërdrejtë apo edhe nëpërmjet faqes zyrtare në internet, ku përditësoheshin statistikat e të diplomuarve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të</b>



<b>brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, Senati Akademik i Universitetit EPOKA ka krijuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Struktura dhe dokumentacioni përkatës është publike në faqen kryesore të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (<a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a>).</p> <p>Struktura kryesore në nivel institucional është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), me nën-njësitë e tij si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,</li> <li>- Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, dhe</li> <li>- Bordi i Provimeve.</li> </ul> <p>Struktura dhe funksionimi i KPSC dhe nën-njësite të saj janë përcaktuar në Statutin e Universitetit EPOKA, në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC, dhe në Manualin e Universitetit EPOKA për Sigurimin e Cilësisë</p> <p><i>Ref. Statuti i IAL-së (neni 35 &amp; 37), Rregullore të njësisë të sigurimit të brendshme të cilësisë NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me nën-njësitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përbëjnë sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit EPOKA. Struktura dhe funksionimi i KPSC dhe njësite të saj përcaktohen në Statutin e Universitetit, si dhe Rregullorja “Për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC”, Manuali i Sigurimit të Cilësisë të Universitetit Politikën e Cilësisë dhe Politikën, dhe Direktiva “Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit” (të gjitha rregulloret janë bashkangjitur në shtojcat e RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Universiteti EPOKA përdor Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative, hartimin e Planit Strategjik pesë-vjeçar, hartimin e Plan-veprimeve, si një proces vijues i përmirësimit të cilësisë brenda institucionit. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm të përgatitur në kuadër të akreditimit të institucionit dhe programeve të studimit.</p> <p>Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, Universiteti i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike dhe krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të</p>	<p>Universiteti ka hartuar Politikën e Cilësisë dhe Politikën për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. Kjo politikë synon të sigurojë dhe të përmirësojë cilësinë e programeve të studimit, si dhe për të krijuar një kulturë të cilësisë në nivelin institucional.</p>

Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<i>Ref.: Regullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Rregullore e NJSBC</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Departamenti është njesia bazë përgjegjëse për mirë funksionimin e programit të studimit dhe për të siguruar cilësinë e saj. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse, e rregulluar me anë të politikës “Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit”. Propozimi i departamentit për përmirësimin e kurrikulës për programet e studimeve përkatëse shqyrtohen nga Dekanati. Vendimi i Dekanatit mbi propozimet dërgohet në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave, më pas propozimi dërgohet për shqyrtim në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin të Cilësisë.  Senati Akademik merr vendimin përfundimtar mbi përmirësimin e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	E gjithë procedura e përmendur në Kriterin 1, është formale dhe e mirëdokumentuar. Gjatë kesaj procedure përdoren forma standarte të miratuara, si “Forma e Propozimit për Ndryshimin e Kurrikulave”.  <i>Ref.: Regullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Rregullore e NJSBC</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Vlerësimi i ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit realizohet kryesisht me anë të “Pyetësorit të Vlerësimit të Pedagogëve”, pyetësor I cili plotësohet cdo fund semestri nga studentët. Bordi i Provimeve, përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së provimeve, pregatit raporte vjetore dhe ia paraqet përshqyrtim Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senatit Akademik.  Përdoret gjithashtu edhe vlerësimi i Performancës Akademike në Mësimdhënie, Kërkim Shkencor dhe Projekte, e rregulluar sipas Direktivës “Për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë”.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen në formë raportesh dhe u paraqiten departamenteve përgjegjëse për programin e studimit, Dekanatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë,

	Rektoratit dhe Senatit Akademik. <i>Ref.: Rregullore e NJSBC</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit të cilësisë, të sipërpërmendura në kriteret 1-4, përfshijnë rezultatet e marra si dhe masat në formë rekomandimesh dhe sygjerimesh për përmirësim të vazhdueshëm. <i>Ref.: Rregullore e NJSBC</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Departamenti është njësi bazë që bën vlerësimin sistematik të programit të studimit. Departamenti përgatit raporte, çdo semestër, mbi rezultatet e “Pyetësorit të Vlerësimit të Pedagogëve dhe të Lëndës”, ku përfshin informacion mbi notat përfundimtare të lëndëve dhe rezultatet e reagimit të studentëve.</p> <p>Bordi i Provimeve, përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së provimeve, përgatit gjithashtu raporte vjetore me sygjerime dhe rekomandime. Këto informacione përfshihen në raportet e vetëvlerësimit intitucional.</p> <p><i>Ref.: Regullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë”, Rregullore të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, "Direktivën për Funkionimin e Bordit të Provimeve"</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Reagimet e stafit akademik, reagimet e studentëve dhe raportet e organeve akredituese përdoren kryesisht si instrumente për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	<p>Universiteti përdor instrumenta të drejtpërdrejta për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies- me anë të formularit “Për Vlerësimin e Mësimdhënies”, i cili plotësohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit;</li> <li>vlerësimin e kurrikulës- me anë të Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave;</li> <li>vlerësime paralele të provimeve- realizuar nga ekspertët e programeve të studimit, të caktuar nga fakulteti përkatës, për të vlerësuar cilësinë e provimeve.</li> <li>vëzhgime në auditor (në raste specifike), etj.</li> </ul>

	<i>Ref. Rregullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	<p>Në shërbim të përmirësimit të cilësisë, Universiteti, me anë të strukturës së Dekanatit të Studentëve, realizon tre lloje pyetësorësh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësori për të matur nivelin e kënaqshmërisë së studenteve</li> <li>• Pyetësori për studentat e diplomuar për të matur efektivitetin e programit të studimit</li> <li>• Pyetësori për kompanitë që kanë punësuar studentë të diplomuar të Universitetit EPOKA.</li> </ul> <p><i>Ref.: Pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, Pyetësori i Kënaqshmërisë së Studentëve, Pyetësori për Studentët e Diplomuar</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i strukturës dhe dokumentacionit të Sistemit e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, u konstatua se institucioni ka ngritur mekanizmat e mjaftueshme, me përfaqësues anëtarësh të brëndshëm dhe të jashtëm. Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. KPSC përbëhet nga të paktën 8 (tetë) anëtarë, mes të cilëve një Kryetar, një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore me të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe pa detyra drejtuese të nivelit të lartë, të paktën dy anëtarë të stafit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist i jashtëm me përvojë në çështjet e sigurimit të cilësisë. Anëtarët zgjidhen nga Senati Akademik, për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p><i>Ref.: Njësia e monitorimit të Kurrikulës/Rregullorja e zyrës, Rregullore e NJSBC</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Në statutin e universitetit EPOKA, si dhe në rregulloret e tjera specifike (referohu shtojës 13 dhe shtojcës 3 në RVB), institucioni përcakton përgjegjësitë dhe detyrat specifike të njësive kryesore, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ref.: Rregullore e NJSBC</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjëse për mirë funksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Konstatohet se përgjegjësi i programit të studimit, personeli akademik e administrative, si dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ref.: Njësia e monitorimit të Kurrikulës/Rregullorja e zyrës, Rregullore e NJSBC</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Senati Akademik i Universitetit është struktura që vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me integritetin akademik duke shmangur cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>Ref.: Rregullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë", Rregullore të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, "Direktivën për Funksionimin e Bordit të Provimeve"</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. KPSC përbëhet nga të paktën 8 (tetë) anëtarë, mes të cilëve një Kryetar, një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore me të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe pa detyra drejtuese të nivelit të lartë, të paktën dy anëtarë të stafit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist i jashtëm me përvojë në çështjet e sigurimit të cilësisë. Anëtarët zgjidhen nga Senati Akademik, për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p><i>Ref.: Rregullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë", Rregullore të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, "Direktivën për Funksionimin e Bordit të Provimeve"</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, së bashku me strukturat dhe procedurat përkatëse, janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në faqen kryesore të internetit të Universitetit</p> <p><a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-qa-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-qa-documents-1404.html</a></p> <p><a href="http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html">http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit</p>	<p>Institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Universiteti organizon trajnime për stafin</p>



të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	akademik dhe administrativ për "Mbrojtjen e të dhënave" nga Komisioneri për Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Plan veprimi i departamentit është i bashkangjitur në shtojcat e RVB. Forma e Planit të Veprimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të adresuar rekomandimet nga Bordi i Akreditimit dhe përfshin afatet kohore për plotësimin e secilit rekomandim. Gjithashtu, njësitë administrative dhe akademike përgatisin plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të kontrollit të brendshëm të Universitetit.  <i>Ref.: Përbushja e rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe/ose akreditimi i mëparshëm</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm.  <i>Ref.: Regullorja e zyrës për monitorimin e kurrikulës, Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë", Rregullore të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, "Direktivën për Funksionimin e Bordit të Provimeve"</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë organizon rregullisht trajnime për stafin.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" të Universitetit "Epoka"**

#### **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimeve Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ofrohet nga Universiteti Epoka, i cili ka një imazh shumë të mirë lidhur me cilësinë e produkteve të tij. Tek këto produkte futen edhe kontigjentet që kanë përfunduar PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi, të cilët preferohen jo vetëm nga tregu i punës (rreth 80%) por edhe nga ciklet më të larta të studimeve (rreth 8%)



2. Programi i studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ofrohet me veçorinë e zhvillimit të mësimin në anglisht çfarë bën që ai të jetë i preferuar për t’u ndjekur, sidomos nga ata që duan të vazhdojnë ciklet e larta të studimit jashtë Shqipërisë. Ky pohim është bërë edhe nga studentët e këtij PS gjatë takimit që GVJ zhvilloi me to.
3. Programi i studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” zhvillohet në kushtet e një kampusi, ku të gjitha ambientet janë dizenuar në plotësim të standarteve më të mira si për mësimin ashtu edhe për aktivitetet mbështetëse të tij. GVJ i vizitoi të gjitha ambientet në dispozicion të studentëve të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe konstatoi plotësimin e të gjitha standarteve në dobi të aktivitetit të tyre.
4. Kompozimi administrativ i këtij Programi Studimesh, i përfshirë në kompozimin e përgjithshëm administrativ të universitetit Epoka, përcjell tek studentët ndjesinë e trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv. GVJ konstatoi që studentët e këtij PS vlerësonin që zgjidhjet e ofruara nga zyrat në mbështetje të aktivitetit të tyre, brenda e jashtë Departamentit, i çonin ata në plotësimin në kohë e me cilësi të kërkesave dhe ankesave të tyre, duke u kursyer kohën në dobi të procesit mësimor e kërkimor shkencor.
5. Personeli akademik i këtij PS, edhe si pjesë përbërse e personelit akademik të Universitetit Epoka, ndjehet i vlerësuar e, për këtë edhe i përkushtuar në angazhimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe për të merituar vlerësimin e studentëve.
6. Caktimi i një këshilltari akademik për çdo student edhe në këtë PS, rrit sigurinë e studentëve në përballimin me sukses të gjithë problematikës gjatë kohës së studimeve.
7. Akordimi i bursave edhe për këtë PS vlerësohej shumë nga studentët. Ata e gjenin atë edhe objektiv edhe stimulues. Ky fakt e bën këtë PS të lakmueshëm nga studentët e dalluar të cilët kanë vështirsi në përballimin e shpenzimeve.
8. Përvoja e krijuar në këtë PS lidhur me sigurinë si të punësimit ashtu edhe të vazhdimin në ciklet e tjera të studimeve (sidomos jashtë vendit) i jep atij përparsi në zgjedhje kundrejt ofertave të njejtë.

### **Pika të dobta/pika për përmirësim të mëtejshëm:**

1. Varësia e drejtpërdrejtë e buxhetit nga tarifat e studentëve mund të çojë në rritjen e tyre në masë të papërbalueshme nga kontigjentet hyrëse.
2. Në nivelin aktual gjykohet që njohja më e plotë (edhe në aspektin teorik me shtimin e një lënde si “Punimet në Kantier”) me aktivitetet në kantier do të forconte më tej aftësinë vepruese të të diplomuarve në këtë PS

### **Rekomandime:**

1. Të rriten të ardhurat financiare nga bashkëpunimi me të tretët me synimin që ato të krijojnë potenciale më të forta për rinovime të teknologjisë së mësimdhënies
2. Të forcohet pjesëmarrja në projekte strategjike kombëtare pasi kështu do të rritej pesha e vlerësimit për institucionin
3. Të përmirësohet dhe standartizohet në vijimësi kurrikula e PS me synimin që të lehtësohet më tej mobiliteti i studentëve drejt cikleve të studimit master si dhe të bëhet më praktik e më i dobishëm angazhimi i të diplomuarve të këtij PS në kantier.

## **Conclusions for the Evaluation of the first cycle Bachelor study program in "Civil Engineering" at "Epoka" University**

### **Strengths and affirmations**

1. The Bachelor study program in "Civil Engineering" is offered by Epoka University, which has a very good image regarding the quality of its services. In these services are also included the contingents that have completed the Bachelor SP in Civil Engineering, which are preferred not only by the labor market (about 80%) but also by higher study cycles (about 8%)
2. The Bachelor study program in "Civil Engineering" is offered with the peculiarity of lessons developed in English, which makes it more preferred to be attended, especially by those who want to continue the higher cycles of study abroad Albania. This statement was also made by the students of this SP during the meeting that GVJ held with them.
3. The Bachelor study program in "Civil Engineering" takes place in a campus where all facilities are designed to meet the best standards for both teaching and supportive activities. GVJ visited all facilities available to the students of the Civil Engineering Department and found that all standards were fulfilled for the benefit of their activity.
4. The administrative composition of this Study Program, which is included in the general administrative composition of Epoka University, conveys to students the feeling of equal treatment and objective evaluation. GVJ found that the students of this SP appreciated the fact that the solutions provided by the offices in support of their activity, inside and outside the Department, led them to the fulfillment in time and quality of their requests and complaints, saving time in favor of teaching and research process.
5. The academic staff of this SP, as an integral part of the academic staff of Epoka University, feels appreciated and, therefore, dedicated to its commitment to achieve the best possible results and to deserve the appreciation of students.
6. Assigning an academic advisor for each student in this SP, increases the confidence of students in successfully coping with all problems during their studies.
7. The awarding of scholarships in this SP was also highly appreciated by the students. They consider it stimulating and also a goal. This fact makes this SP enviable by good students who have difficulty in affording expenses.
8. The experience created in this SP regarding the security of both employment and attendance of other study cycles (especially abroad) gives it an advantage in elections over the same offers.

### **Weaknesses / points for further improvement:**

1. The direct budget dependency on student fees can lead to their growth till an unaffordable extent by the incoming contingents.

2. In the current situation, it is considered that a deeper knowledge (even in a theoretical aspect by adding a subject as "Construction Site Works") of the construction site activities would further strengthen the operational capacity of the graduates in this SP.

**Recommendations:**

1. Increasing the financial income by cooperating with third parties in order for them to create stronger potentials for the innovation of teaching technology.
2. To strengthen the participation in national strategic projects as this would increase the evaluation of the institution.
3. To continuously improve and standardize the SP curriculum with the aim of further facilitating the mobility of students towards master study cycles and to make the recruitment of the graduates of this SP on the construction site more practical and useful.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X